



Republika e Kosovës
Republika Kosovo-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština – Assembly

Legjislacioni IV
Sesioni pranveror
Komisioni për Punë të Jashtme
Mbledhja nr. 29
Prishtinë, më 28 mars 2012, në orën 11:00
Ndërtesa e Kuvendit, salla N-225

P r o c e s v e r b a l

I mbledhjes së Komisionit për Punë të Jashtme

Në mbledhje morën pjesë: Albin Kurti, Hydajet Hyseni, Enis Kervan, Shaip Muja, Sabri Hamiti, Skender Hyseni, Amir Ahmeti, Petar Miletij .

Mungoi: Donika Kadaj-Bujupi.

Pjesëmarrës të tjerë: Lumnije Murati – ZPRK; Shkumbin Beqiri-KDI; Puhie Demaku - Kuvendi Kosovës; Driton Sylja-KPJ; Besarta Zuka-NDI dhe media.

Nga Zyra e Komisionit: Minire Hasani dhe Manush Krasniqi.

Mbledhjen e kryesoi, Albin Kurti – kryetar i Komisionit.

Në këtë mbledhje u propozua ky

R e n d d i t e:

1. Miratimi i rendit të ditës;
2. Miratimi i procesverbalit të datës 29 shkurt 2012;
3. Raportim i ministrit z. Ibrahim Makolli, lidhur me aktivitetet e Ministrisë së Diasporës;
4. Takim me përfaqësuesin e organizatës mbështetëse të komisioneve parlamentare, NDI;
5. Të ndryshme.

1. Miratimi i rendit të ditës

Kryetari konstatoi se Komisioni e miratoi rendin e ditës, duke hequr pikën 4 në mungesë të z. Alex Chavaria, përfaqësues i organizatës mbështetëse të komisioneve parlamentare, NDI .

2. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së datës 29 shkurt 2012

Kryetari konstatoi se Komisioni e miratoi procesverbalin nga mbledhja e datës 29 shkurt 2012, me këto vërejtje:

Fjalja: "Të kërkohet teksti origjinal i marrëveshjes së arritur në Bruksel dhe përkthimi zyrtar i atij teksti", të korrigjohet si vijon: "Të kërkohet teksti origjinal i marrëveshjeve të arritura në Bruksel dhe përkthimi zyrtar i atyre teksteve".

Në faqen 4 të procesverbalit, fjalët: "në këtë pranverë ka qenë", të korrigjohen si vijon: "në këtë pranverë ka me qenë".

3. Raportim i ministrit, z. Ibrahim Makolli lidhur me aktivitetet e Ministrisë së Diasporës

Ibrahim Makolli- Sipas kërkesës së Komisionit, ka dorëzuar raport me shkrim lidhur me punën e Ministrisë së Diasporës gjatë periudhës qershor 2011-shkurt 2012. Në raportimin e tij në Komision, foli mbi aktivitetet e gjertanishme të Ministrisë së Diasporës. Njoftoi anëtarët e Komisionit mbi themelimin e Ministrisë së Diasporës, infrastrukturën ligjore të saj, aktivitetet e ndërmarra për diasporën, hartimin e marrëveshjes me Universitetin e Prishtinës, angazhimin për hapjen e bibliotekave në vendet ku jeton dhe vepron mërgata dhe për konferencat e organizuara nga Ministria. Me qëllim të krijimit të kontakteve dhe marrjes së gjendjes së diasporës, ai njoftoi për vizitat e realizuara në këto shtete: Austri, Angli, SHBA, Francë, Zvicër, Gjermani, Suedi dhe për ndërmarrjen e hapave për hapjen e tri qendrave kulturore për diasporën në përputhje me Ligjin për mërgatën.

Amir Ahmeti- Theksoi se është një kohë e shkurtër e themelimit të kësaj Ministrie dhe se nevojitet kohë për organizimin e brendshëm të saj. Ai falënderoi ministrin Makolli për përkushtimin për të qenë transparent ndaj legjislativit dhe këtij Komisioni. Në bazë të raportit me shkrim dhe tani raportimit në Komision, për punën e bërë të kësaj Ministrie dhe aktivitetet e saj, e përgëzoi ministrin Makolli.

Hydajet Hyseni- E vlerësoi lart punën e bërë në këtë Ministri të re, për të cilën tha se përkundër sfidave me të cilat është përballur, ka arritur një sërë suksesesh. Termat e përdorur në raport, si: "diaspora, mërgata dhe emigracioni", tha se duhet harmonizuar duke u mbështetur në përvojat e vendeve të tjera, siç mund të jetë përvoja e Kroacisë. Propozoi që të shqyrtohet mundësia për hartimin e një broshure me informata për Kosovën, me udhëzime për zgjidhjen e problemeve me të cilat përballen mërgimtarët tanë dhe në konsultim me aeroportet, mërgimtarët tanë t'i kenë këto në fillim të udhëtimit si lehtësim. Ndër çështjet që vlen të rishqyrtohet, është taksa e sigurimit të cilën e paguajnë mërgimtarët tanë, e cila nuk aplikohet askund në Evropë. Po ashtu edhe për qytetarët e Luginës së Preshevës, taksa e cila po zbatohet është e papërbalueshme dhe duhet rishikuar e gjetur zgjidhje sipas praktikave të vendeve të tjera, që të mos diskriminohen qytetarët. Kërkoj kujdes më të madh të institucioneve tona për rastet me të cilat mund të përballen qytetarët tanë, siç ishte rasti me Shemsi Nuhiun, i cili edhe pse kishte shtetësinë e Kosovës, nuk u arrit që të ketë kujdesin e duhur të shtetit të Kosovës.

Skender Hyseni - Çështje të rëndësishme për diasporën e vlerëson socializimin, përkatësisht integrimin e mërgimtarëve përmes shkollimit cilësor që ju ofrohet atje. Aspekt i veçantë në këtë drejtim do të duhej t'i kushtohej femrave në diasporë.

Ndërmarrja e fushatave nga ana e Ministrisë në këtë rrafsh specifik, nuk do të kushtonte shumë dhe do të ndikonte në rritjen e ambicieve intelektuale të diasporës në përgjithësi.

Sabri Hamiti- Në diskutimin e tij shtroi çështjen e koordinimit të Ministrisë së Diasporës me Ministrinë e Punëve të Jashtme, shërbimin diplomatik, e pastaj edhe me ministrinë tjera, lidhur me veprimtaritë që planifikohen të bëhen për diasporën.

Planifikimi për hapjen e qendrave kulturore në Turqi, Zvicër e SHBA, tha se për nga veprimtaria do të dallojnë nga prioritetet e tyre dhe shtroi çështjen e koordinimit të këtyre qendrave me përfaqësitë e sektorëve të MPJ-së. Gjithashtu, duhet shqyrtuar edhe raportin ekonomik Kosovë-diasporë nga ministrinë përkatëse, me qëllim të nxitjes së investimeve në Kosovë. Propozoi që të gjinden instrumente për regjistrim të diasporës, për të ditur statusin e tyre: sa janë në numër, sa punojnë, çfarë është kualifikimi i tyre dhe çfarë është fuqia e tyre ekonomike?

Albin Kurti- Duke u ndërlidhur me raportin e ministrit, kërkoi që t'i dorëzohet Komisionit- Strategjia e zhvillimit për periudhën afatmesme 2012-2014. Në aktivitetet e Ministrisë së Diasporës të paraqitura në Raport, tha se nuk janë të cekura datat e zhvillimit të këtyre aktiviteteve.

Lidhur me konferencën me temën: "Sfidat bashkëkohore të mërgatës në rrafshin social e shëndetësor", ai pyeti: Nga kush është organizuar, sa ekspertë të diasporës janë ftuar dhe si janë përzgjedhur ata?

Sërish pyeti: Kush e ka bërë prezantimin e hulumtimit "Perceptimi i Diasporës" dhe kush e financoi atë, si është paraparë ndërlidhja e qendrave kulturore të Kosovës në diasporë me ambasadat dhe si do të zgjidhen përfaqësuesit në këto qendra kulturore? Pajtohet me diskutimin e deputetit H. Hyseni për standardizimin e terminologjisë që ka të bëjë me diasporën. Shtroi edhe një varg pyetjesh për të cilat tha se janë të bashkatdhetarëve tanë dhe është mirë të merren parasysh me rastin e hartimit të strategjisë dhe të planit të punës së Ministrisë, ndërsa përgjigjja për këto pyetje mund të bëhet edhe me shkrim.

Shaip Muja- Tha se është i nevojshëm koordinimi i Ministrisë së Diasporës me ambasadat në operacionalizimin e punëve. Po ashtu, shtroi edhe çështjen problematike të mërgimtarëve tanë, të cilët pensionohen dhe dëshirojnë të kthehen për të jetuar në Kosovë, pasi që sipas legjislacioneve të vendeve të ndryshme, ata hasin në vështirësi. Këtë e konsideron si shkelje e të drejtave të njeriut, ngase mërgimtarët në ato vende ku kanë punuar, i kanë paguar të gjitha kontributet. Shteti ynë duhet këmbëngulur në të drejtën e mërgimtarëve, që pas pensionimit të zgjedhin vetë se ku dëshirojnë të jetojnë. Në Ministrinë e Diasporës, operacionalizimi i punëve në të ardhmen duhet të rritet, përkundër vështirësive të cilat i ka kjo Ministri me numër të vogël të stafit dhe me mjete të kufizuara për funksionalizimin e aspiratave të parapara. Në këtë drejtim, ai theksoi se të gjitha ministrinë kanë departamentet për bashkëpunim ndërkombëtar, me të cilat Ministria e Diasporës mund të ketë qasje dhe bashkëpunim për gjetjen e mënyrave për investime të diasporës në Kosovë.

Ibrahim Makolli- Duke u ndërlidhur me diskutimet dhe pyetjet e parashtruara nga deputetët, fillimisht theksoi se është në interes të përbashkët që Ministria të raportojë dhe të bashkëpunojë me Komisionin. Edhe pse Ministria e Diasporës është një ministri e re,

nuk ka filluar nga zero, ngase edhe më parë çështja e diasporës është trajtuar nga Departamenti për Çështje Jorezidente dhe Agjencia e Mërgatës. Regjistrimi i mërgatës tha se është i domosdoshëm, ku është e përqendruar, cili është profili i saj, ngase absolutisht është e pamundur të hartohen strategji dhe plane, nëse nuk dihet numri i saj. Ky është një proces që nuk mund të bëhet shpejt. Jemi në proces të hartimit të një broshure lidhur me informatat për Kosovën, për nevojat dhe të drejtat e mërgimtarëve me rastin e ardhjes së tyre, i cili kërkon kohë. Lidhur me poliset kufitare të sigurisë, tha se nga fillimi na kanë shqetësuar dhe për këtë ka pasur kontakte me Shoqatën e Sigurimeve, Bankën Botërore, dhe se ka zhvilluar takime me autoritetet në Zvicër, Gjermani e Austri, në mënyrë që shoqatat e sigurimit të tyre të krijojnë marrëveshje të përbashkëta me shoqatat e sigurimit në Kosovë, për t'ia njohur njëra-tjetrës poliset e sigurimit. Njoftoi se për rastin e Shemsi Nuhiut ka pasur takime me Ministrinë e Drejtësisë në Zvicër dhe ka kërkuar që të mos ekstradohet, duke pasur parasysh përvojën e hidhur që e kemi me Serbinë. Mërgata jonë është integruar pjesërisht dhe jemi duke ndërtuar mekanizma për ta përkrahur integrimin e tyre në shoqëri dhe për ta parandaluar asimilimin e mundshëm të tyre. Vetëm 5% është pjesëmarrja e mërgatës në mësim plotësues dhe jemi në përpjekje të arritjes së marrëveshjeve me autoritetet e vendeve, që mësimi plotësues në gjuhën amtare të jetë pjesë e programit shkollor. Pjesë përbërëse e mësimin plotësues duhet të jenë: gjuha, kultura, historia, gjeografia. Për profilin e mësimdhënësit për mësim plotësues duhet shikuar mundësinë me Ministrinë e Arsimit, UP-në dhe Fakultetin e Edukimit. Ministria e Diasporës ka bashkëpunim të mirë edhe me Ministrinë e Tregtisë dhe Industrisë, për hulumtimin e formave të ndryshme për të përkrahur investitorët. Qendrat kulturore për diasporën kanë karakteristikat e veta, sepse secili vend ka specifikat e veta dhe këto qendra duhet t'u përshtaten nevojave të mërgatës sonë. Strategjia e zhvillimit për periudhën afatmesme 2012-2014 tha se është publike dhe atë do t'ia përcjellim Komisionit, ndërsa datat e realizimit të aktiviteteve nuk janë paraqitur në raport, në mënyrë që të mos ngarkohet raporti dhe të njëjtat do t'ia përcjellin sa më parë Komisionit. Lidhur me Strategjinë për diasporën, tha se ajo do të përfundojë brenda tre apo katër muajve, pasi të miratohet ligji.

Hulumtimi "Perceptimi i diasporës", tha se është bërë në bashkëpunim me një universitet privat të Prishtinës, i cili ka pasur kosto financiare dhe raporti mbi këtë hulumtim mund t'i përcillet Komisionit. Zgjedhja e përfaqësuesve të qendrave kulturore parashihet me ligj, mirëpo varet edhe prej deputetëve të Kuvendit të Kosovës se çfarë do të jetë ajo zgjedhje. Ministri Makolli u përgjigj edhe në shumë pyetje të tjera të përcjella nga mërgimtarët tanë: për pritjet në kufi tha se janë monitoruar pikat kufitare, por nuk ka pasur ndonjë problem dhe është kërkuar që të ketë hyrje të veçantë për mërgimtarët tanë; rezultatet konkrete nga udhëtimet dhe kontaktet me mërgimtarët dhe autoritet e vendeve, ka qenë interesimi për të mësuar lidhur me çështjet të cilat e preokupojnë mërgatën; nuk ka informacion se në ndonjë konferencë është thënë se mërgata jonë nuk ka investuar, ajo ka investuar dhe është e interesuar të investojë në Kosovë; për pjesëmarrjen e mërgatës në zgjedhje është kërkuar nga komisionet parlamentare që në ndryshimet kushtetuese të parashihet mundësia e rezervimit të vendeve për mërgatën tonë dhe mundësia e organizimit të zgjedhjeve në vendin ku jeton mërgata jonë; Ministria e Diasporës e ka faqen e vet të internetit; nuk ka marrë pjesë në asnjë turnir futbollit në Zvicër, përkundër nevojës që të

përcillen aktivitetet e mërgatës sonë; ekziston një bashkëpunim i mirë me ambasadat tona dhe koordinimi i veprimeve.

Në këtë drejtim, ai shtoi se është e nevojshme që të kërkohet nga MPJ-ja që në periudhat kohore kur ka kërkesa të mëdha të mërgatës për t'u pajisur me dokumente të udhëtimit, të shtohen kapacitetet e zyrtarëve në konsullata apo edhe të krijon ekiye mobile që të jenë më afër njerëzve tanë atje.

Lidhur me pyetjet e bëra nga mërgimtarët tanë, ai theksoi se do të përgjigjet me shkrim.

Ai tha se Komisionit do t'ia përcjellë Planin e veprimit për vitin 2012, si dhe Strategjinë zhvillimore të Ministrisë për vitin 2012-2014 dhe është i gatshëm që në çdo kohë t'i përgjigjet ftesës së Komisionit.

Albin Kurti- Shtroi çështjen e gjetjes së ndonjë ideje së bashku me Gjermaninë për më se 100 mijë të kthyer nga Gjermania, të cilët atje kanë qenë të specializuar në ndonjë lëmi, ndërsa këtu nuk mund të gjinden në atë profesion. Mundësinë e arritjes së një marrëveshje kolektive Kosovë-Gjermani për shmangie nga pagesa individuale e heqjes së shtetësisë së Serbisë, si dhe kërkoi të informohet se kush kanë qenë ekspertët të cilët kanë marrë pjesë në konferenca në diasporë dhe si janë seleksionuar atje.

Ibrahim Makolli- Lidhur me çështjen e heqjes së nënshtetësisë së dyfishtë, që kërkohet vetëm në landin e Bayernit, tha se ka pasur kontakte me autoritetet e Gjermanisë, ndërsa lidhur me këtë çështje është në bisedime me Ministrinë për Integrime të Gjermanisë. Sa u përket ekspertëve në diasporë, tha se janë diku 110-111 ekspertë të fushave të ndryshme që janë shkolluar dhe veprojnë në Gjermani. Njoftoi se MD-ja është duke punuar edhe për pjesëmarrjen e mërgatës në diplomacinë publike që është shumë e rëndësishme dhe ka kapacitetet të mjaftueshme për t'ju qasur edhe kësaj fushe.

4. Të ndryshme

Albin Kurti- Njoftoi anëtarët e Komisionit se në ftesën që i është bërë Komisionit për Punë të Jashtme të Parlamentit Hungarez, kemi përgjigjen se vizita e tyre nuk mund të realizohet në muajin maj, për shkak të agjendës së tyre dhe e njëjta do të mund të realizohet në muajin shtator.

Takimi përfundoi në orën 12:50.

E përgatiti:

Njësia për Mbështetjen e Komisionit.

Kryetari i Komisionit

Albin Kurti

